



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për Shtyp

Mbi 5 vjetorin e Autoritetit të Konkurrencës dhe konkluzionet e Konferencës Ndërkombëtare “Konkurrenca në ekonomitë e vogla dhe informale”

Autoriteti i Konkurrencës, si një nga institucionet publike që mbikëqyr funksionimin e tregut, festoi 5 vjetorin e fillimit të aktivitetit më datë 3 Mars 2009. Në funksion të rritjes së kulturës për ligjin dhe politikën e konkurrencës, dita e përvjetorit nuk u konceptua vetëm si ditë festive, por edhe ditë e diskutimit të hapur me palët e interesit, akademikët dhe ekspertët e autoriteteve të konkurrencës nga vendet e tjera nëpërmjet organizimit të Konferencën Ndërkombëtare me temë “Konkurrenca në ekonomitë e vogla dhe informale”.

Kjo ngjarje shënon edhe festimin e përvitshëm të Ditës Kombëtare të Konkurrencës, e cila konsiderohet si dita e promovimit të së drejtës së konkurrencës. Në këtë kontekst , konferenca u konceptua në tre pjesë: pjesa e përshëndetjeve; seanca e shkëmbimit të eksperiencave ; si dhe seanca e trajtimit teorik dhe praktik të aspekteve të zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës në kushtet e ekonomisë së vogël dhe informale.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetarja e Komisionit të Konkurrencës znj. Lindita Milo(Lati) ndërsa konferenca u përshëndet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës z. Genc Ruli, kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi dhe Financë, z. Edmond Spaho, përfaqësuesi i Delegacionit të Komisionit European në Tiranë, z. Luigi Brusa .

Kjo konferencë mundësoi shkëmbimin e eksperiencave midis Komisioneve të Konkurrencës të vendeve të rajonit si Çekia, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia, Kosova, Serbia, Turqia, Kroacia etj. Prezantimet e përfaqësuesve të Autoriteteve të Konkurrencës u përqëndruan në sfidat e zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës në vendet me ekonomi të vogël dhe kryesisht informale. Folësi kryesor në sesionin e diskutimeve të prezantimeve të studiuësve që sollën kontributet e tyre ishte profesor Nail Kay nga Universiteti Strathclyde.

Në mbyllje të konferencës, Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, znj. Lati, theksoi se, gërshetimi i politikës së konkurrencës me politikat e tjera ekonomike dhe në mënyrë të veçantë atë tregtare, është imperative për ekonomi të vogël për shkak të numrit relativisht më të vogël të konkurrentëve dhe madhësisë së kërkesës.

Një tjetër konkluzion i konferencës ishte forcimi i pavarësisë, kapaciteteve administrative dhe efektivitetit të Autoriteteve të Konkurrencës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe aplikimi i të njëjtave, parime të politikës së konkurrencës si në vendet e zhvilluara, merr rëndësi të madhe për autoritetet e reja të vendeve të rajonit. Asistenca teknike, bashkëveprimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i ekspertëve, përbëjnë shyllat bazë të përmirësimit të vazhdueshme dhe të konsolidimit të kapaciteteve institucionale. Këto faktorë duhet të konsiderohen të gërshetuar dhe të pandashëm nga njëri-tjetri.

Folësit konkluduan se ekonomia informale përbën një kërcënim të vazhdueshëm të rregullave të lojës në ekonominë e tregut dhe mund të ketë relativisht presione konkurruese në periudha afatshkurtra. Por, në periudha afatgjata një ekonomi më e formalizuar rrit aksesin në teknologji dhe fonde, rrit produktivitetin dhe efikasitetin e ndërmarrjes dhe në këtë mënyrë rrit konkurrencën në treg duke sjelle me shume zgjedhje, me çmime më të ulta për konsumatorët.

Në ekonominë e vogla, theksuan folësit, duhet të sigurohet një “ekuilibër” optimal midis madhësisë së ndërmarrjeve dhe konsiderimit të pozitës dominuese; marrëveshjeve të ndaluara (rregullat e minimis) dhe kontrollin e përqendrimeve duke mbajtur në konsideratë efektet e ekonomisë së shkallës.

Konferenca arriti në konkluzionin se aplikimi i ligjit të konkurrencës duhet parë si një gërshetim mes praktikave më të mira të vendeve të zhvilluara dhe veçorive që kanë vendet në zhvillim për të rritur efektivitetin e ndërmarrjeve dhe për të siguruar një treg sa më konkurrues. Por, theksi vihet në punën e vazhdueshme për rritjen e kulturës dhe advokatisë për konkurrencën dhe bazën ligjore që e mbikëqyr atë. Mirëfunksionimi i tregut është kombimin i veprimtarisë së aktorëve dhe faktorëve që ndikojnë në funksionimin e mekanizmave të tij.